



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Be New" LLC të datës 17.05.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 15.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me inventar shkollor për artikujt që nuk janë në AQP - Dollap metalik" me nr. të prokurimit 616-24-1180-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Be New" LLC të datës 17.05.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 15.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me inventar shkollor për artikujt që nuk janë në AQP - Dollap metalik" me nr. të prokurimit 616-24-1180-1-2-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 15.05.2024 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Be New" LLC si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Be New" LLC (tutje "parashtruesi") me datë 17.05.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 15.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me inventar shkollor për artikujt që nuk janë në AQP - Dollap metalik" me nr. të prokurimit 616-24-1180-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "OE i rekomanduar per kontrate nuk ka prezantuar raportin testues SVHC per produktin e ofertuar,ashtu siç është kërkuar ne dosjen e tenderit respektivisht tek pjesa e përshkrimit te paramases. Test raporti i paraqitur nga OE i rekomanduar nuk ka te bëjë fare me test raportin SVHC te produktit ,ashtu siç eshte kërkuar ne dosje por eshte prezantuar nje test raport krejtësishte tjetër qe nuk lidhet fare me kerkesen e dosjes. Duke u bazuar ne qasjen e kufizuar ne dokumente te OE fituese , konsiderojme se ne baze te dukjeve certifikatat ISO jane me formate te ndryshme dhe kerkojme nga AK qe te rishikojë keto certifikata a jane te nje prodhuesi dhe a jane valide , me qene se ne nuk kishim qasje te plote por vetem nje qasje te pastruar (duke mos patur mundesi te shohim emrin e kompanise certifikuese respektivisht prodhuese) . Po ashtu, ofertat e OE Europrint Group Shpk; NTG Blendi OP dhe Delfina Home L.L.C, jane oferta te papërgjegjshme ,pasi qe te gjithë keta ofertues, nuk kan dorezuar-paraqitur test raportin e SVHC per produktin e ofertuar ashtu siç është kërkuar ne dosje".

Lidhur me pretendimin ankimor duhet sqaruar se ky pretendim ndërlidhet me kërkesën e dosjes së tenderit ku në paramasë përcaktohet se duhet të bashkangjitet edhe test raporti për SHVC. Nga analizimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar është gjetur se i njëjti ka dorëzuar dy faqe të një test raporti të vjetër mbi 10 vite konkretisht të datës 6 maj 2014 ku është i fshirë emri i subjektit për të cilin është lëshuar ky test raport. Mbi të gjitha ky raport nuk ndërlidhet me SHVC dhe në fakt aty nuk përmendet fare akronimi SVHC apo termi përkatës në gjuhën angleze (Substance of Very High Concern). Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi ankimor është i bazuar në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 22.05.2024

Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.